




Mbështetur financiarisht  
nga Bashkimi Evropian

**GREEN  
CROSS**

# BIODIVERSITETI! VLERAT, KËRCENIMET DHE RUAJTJA E TIJ

RAST DISKUTIMI:  
ZONA KU FITARE HAS-KLINË



**balkan  
green  
foundation**

**EDEN** Qendra Mjedisore  
për Zhvillim  
Edukim dhe Rrjetëzim



**Përgatiti për botim:**

Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (Qendra EDEN) Rr. Bogdanëve, Pall.7 katësh, K.4, Ap.33, Kodi Postar 1025 Tiranë, Shqipëri

**Autor:**

Marjol Meço - Doktor i Shkencave në Biologji Ruajtje, Drejtimi  
Bimor Lektor i Botanikës Sistematike

Manuali **“Biodiversiteti vlerat, kërcënimet dhe ruajtja e tij”** është hartuar në kuadër të projektit ndërkuftar Shqipëri – Kosovë me titull **“Kapërcim i gjelbër- drejt ekonomisë së gjelbër vendore me inves me inteligjente”** i cili mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet në Shqipëri nga Bashkia Has dhe Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN) dhe në Kosovë nga Komuna e Klinës dhe Balkan Green Foundation (BGF).

*Përmbajtja e këtij manuali është përgjegjësi e autorit dhe partnerëve të projektit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

HYRJE .....	4
1. BIODIVERSITETI DHE VLERAT E TIJ.....	5
1.1. Çfarë është biodiversiteti?.....	5
1.2. Biodiversiteti i Shqipërisë.....	6
1.2.1. Biodiversiteti i Hasit.....	6
1.3. Biodiversiteti i Kosovës.....	7
1.3.1. Biodiversiteti i Klinës.....	7
1.4. Vlerat e biodiversitetit.....	8
REZULTATE TË PUNËTORISË.....	9
1.5. Vlerat e evidentuara të biodiversitetit të Hasit dhe Klinës.....	9
1.6. Biodiversiteti dhe zhvillimi i qëndrueshëm.....	10
2. KËRCËNIMET E BIODIVERSITETIT.....	11
2.1. Kërcënimet e biodiversitetit të trojeve shqipëtare.....	11
REZULTATE TË PUNËTORISË.....	12
2.1.1. Faktorët që kërcënojnë biodiversitetin e Hasit dhe Klinës.....	12
3. MBI RUAJTJEN DHE MENAXHIMIN E BIODIVERSITETIT.....	13
3.1. Biologjia e Ruajtjes si përgjigje e zgjuar për ruajtjen e biodiversitetit!.....	13
3.2. Menaxhimi mjedisor si përgjigje për ruajtjen e biodiversitetit.....	13
3.2.1. Parimet themelore për planifikimin dhe hartimin e një plani ruajtje dhe menaxhimi të biodiversitetit!.....	14
3.3. Kush duhet ta ruaj biodiversitetin?.....	16
3.4. Legjislacioni dhe institucionet përgjegjëse për ruajtjen e mjedisit dhe biodiversiteti në Shqipëri.....	16
3.5. Mbi ruajtjen e biodiversitetit të Shqipërisë.....	17
3.6. Ruajtja e mjedisit dhe biodiversitetit në Kosovë.....	19
REZULTATE TË PUNËTORISË.....	20
3.7. Masa dhe veprimtari të sugjeruara për ruajtjen e biodiversitetit të Hasit dhe Klinës.....	20
Bibliografia.....	21

## HYRJE

Manuali është përgatitur në kuadër të projektit “KAPËRCIM I GJELBËR– Drejt ekonomisë së gjelbër vendore përmes investimeve inteligjente” i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar në Bashkinë Has dhe Komunën Klinë, komuna ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës. Projekti ka për qëllim të kontribuojë në një rritje të qëndrueshme ekonomike në rajonin ndërkufitar duke mundësuar kapërcimin e bashkive në ekonominë e gjelbër përmes politikave të integruara, investimeve inteligjente publike dhe rritjes së kapaciteteve. Manuali është produkt mbi trajnimin për rritjen e kapaciteteve zhvilluar në bashkinë Has në tetor 2021. Manuali paraqet vlerat e biodiversitetit të Shqipërisë dhe Kosovës duke u ndalur në përshkrimin e vlerave të biodiversitetit të Hasit dhe Klinës, faktorët që kërcënojnë biodiversitetin, ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, organet përgjegjëse për ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri dhe Kosovë. Manuali bën ndërthurje të pjesës teorike me pjesën praktike të rezultateve të punëtorisë.

*Manuali i drejtohet çdo individi cili do të ndikojë në ruajtjen e biodiversitetit, përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri dhe në Kosovë.*

# 1. BIODIVERSITETI DHE VLERAT E TIJ

## 1.1 Çfarë është biodiversiteti?

Biodiversiteti përfaqëson larminë e gjithë organizmave të gjallë, që do të thotë tërësinë e gjeneve, llojeve dhe ekosistemeve. Ai përfshin të gjitha llojet e kafshëve, bimëve dhe mikro-organizmave. Biodiversiteti mbart kuptimin e ndryshueshmërisë dhe të përhapjes gjeografike, i cili shkon përtej përshkrimit të pasurive të së gjallës.

Për arsye didaktike, biodiversiteti organizohet dhe studiohet në tri nivele:

**Biodiversitetit gjenetik** është larmia e gjeneve të organizmave të ndryshëm. Gjenet lejojnë transmetimin e tipareve (karakteristikave) të veçanta të llojit. Larmia e gjeneve reflektohet në larminë e tipareve të një popullate (p.sh. ngjyra e syve, rezistenca ndaj një sëmundjeje të caktuar etj.)

**Larmia gjenetike** përfshin karakteristikat (tiparet) e gjeneve dhe përhapjen e tyre brenda një lloji, si dhe krahasimin e gjeneve të llojeve të ndryshëm. Larmia e llojeve shprehet përmes numrit të llojeve të gjallë, pozicionit të këtyre llojeve në klasifikimin e organizmave të gjallë dhe shpërndarjes për njësi sipërfaqe. Vlerësohet të jenë afërsisht 10 milion lloje në planetin tonë. Rreth 1 700 000 janë rregjistruar tashmë, nga të cilët më shumë se  $\frac{3}{4}$  janë insekte.



Figura 1. Paraqitje skematike e niveleve të organizimit të një ekosistemi.

**Larmia e Ekosistemeve.** Një ekosistem mund të përkufizohet si "një njësi strukturore dhe funksionale e biosferës apo si segment i natyrës i përbërë nga komuniteti i qenieve të gjalla dhe mjedisi fizik, që ndërveprojnë dhe shkëmbejnë lëndë dhe energji midis tyre" (shkretëtira, pylli, oqeani, etj.). Në tërësi një ekosistem mund të përcaktohet si një njësi ekologjike e një komuniteti biotik (grup bimësh, kafshësh dhe organizmash të tjera të gjalla) së bashku me mjedisin e tyre abiotik (si toka, ujë, drita, temperatura, pjerrësia e terrenit, etj) (Fig. 1). Termi ekosistem është shkurtim i termit "sistem ekologjik". Larmia e ekosistemeve karakterizon ndryshueshmërinë e ekosistemeve, shpërndarjen e tyre në planet dhe marrëdhëniet strukturore dhe funksionale. Studimi i ekosistemeve konsiston kryesisht në studimin e proceseve të caktuara që lidhin komponentët e gjallë (biotikë), me komponentet jo të gjallë (abiotik).

## 1.2 Biodiversiteti i Shqipërisë

Shqipëria është e njohur për larminë e lartë të ekosistemeve dhe habitateve. Brenda territorit të vendit gjenden ekosistemet detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurre përherë të blerta, pyje dhe shkurre gjethegjëra, pyje halor, kullota sub-alpinë dhe alpinë. Pyjet mbulojnë 1.030.000 ha ose 36 % të territorit të vendit dhe kullotat rreth 400.000 ha ose 15%. Rreth 60 % e kullotave (224,000 ha) janë kullota alpine dhe subalpine si dhe livadhe. Përgjatë bregdetit të vendit ka shumë ekosisteme me rëndësi të Mesdheut si: laguna, ligatina, dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet hidrofile dhe higrofile, etj. Komunitetet e litoralit dhe infralitoralit që gjenden përgjatë brigjeve shkëmbore janë shumë të larmishme. Lumenjtë dhe liqenët janë gjithashtu të rëndësishëm për larminë biologjike dhe ekologjike të vendit. Rreth 247 liqene natyrore, shumica e të cilave me origjinë karstike, me përmasa të vogla (nga 1 deri në disa dhjetëra ha) gjenden në gjithë territorin e vendit (Kabo, 1990-1991). Ndër më të mëdhenjtë, më interesantët dhe më të rëndësishmit janë liqenet ndërkufitare të Shkodrës, Ohrit dhe Prespës. Mbi 152 lumenj e përrenj rrjedhin nga Juglindja drejt Veriperëndimit, kryesisht drejt bregdetit Adriatik (Kabo, 1990-1991).

Kjo larmi ekosistemesh ka bërë që Shqipëria edhe pse një territor me sipërfaqe të vogël të ketë biodiversitet llojor të pasur. Njihen rreth 3630 lloje bimësh të larta, që përbën më shumë se 30% e llojeve të përgjithshme që gjenden në Evropë. Kjo është një larmi e madhe po të kemi parasysh se territori shqiptar është vetëm sa 0.28% e sipërfaqes së Evropës. Gjithashtu njihen rreth 2350 lloje bimësh të ulëta, myshqe, alga dhe kërpudha, rreth 1200 lloje algash silicore (diatome) etj. Pavarësisht nga studimet e deritanishme relativisht të kufizuara, dhe që nuk përfshijnë gjithë grupet biologjike shtazore, deri tani për Shqipërinë njihen deri në 5500 lloje shtazor, ku rreth 4880 lloje u përkasin invertebrorëve (rreth 4000 janë insekte) dhe mbi 800 lloje janë vertebrorë.

Relievi i thyer dhe vertikalisht i theksuar kanë krijuar kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri llojesh bimësh relikte, endemikë e subendemikë. Deri më sot njihen 56 lloje me 12 nënlloje bimësh endemike për Shqipërinë, ndërsa 160 lloje të tjerë bimësh janë subendemike të Shqipërisë, ish-Yugosllavisë dhe Greqisë. Midis paleoendemikëve takohen relikte me origjinë shumë të hershme si *Wulfenia baldaccii*, *Forsythia europea*, *Gymnospermium shqipetarum*, ndërsa prej neoendemikëve mund të përmenden *Lunaria telekiana*, *Crepis bertisceae*, *Petasites doerfleri*, *Leucojum valentinum* subsp. *vlorense*, *Aster albanicus* subsp. *pararistoi*, etj. Në Shqipëri gjenden edhe disa rracë bagëtish autoktonë dhe kultivarësh bujqësor. Rreth 30 lloje të korrash janë të lindura në Shqipëri. Gjenden 9 rracë autoktonë të dhive dhe 5 të deleve. Bimët endemike së bashku me kultivarët bujqësor dhe rracat e bagëtive të imëta përbejnë një pauni gjenetike-llojore unikalë për vendin tonë.

### 1.2.1 Biodiversiteti i Hasit

Larmia e relievit dhe e përbërjes gjeologjike e Hasit pasqyrohet në larmi biologjike llojore, ekosistemesh dhe peizazhesh. Nga ky territor i Shqipërisë regjistrohen rreth 315 lloj bimësh në Herbarin Kombëtar (8.75% e florës së Shqipërisë). Gjenden gjithashtu 16 lloje bimësh endemike nga 56 që njihen në të gjithë vendin. Rrethi i Hasit strehon edhe një numër të konsiderueshëm llojesh me status ruajtje kombëtar dhe ndërkombëtar. 37 lloje bimësh kanë status ruajtje në listën e kuqe të Shqipërisë dhe në nivel Evropian/Global. *Ramonda serbica* dhe *Gentiana lutea* janë pjesë e aneksit IV të Direktivës së Habitaveve dhe Direktivës së Bernës. Lloje të rëndësishme të zonës janë edhe ato të regjistruar për herë të parë për Shqipërinë si: *Iris reichenbachii*, *Senecio squalidus* subsp. *rupestris*, *Iris pumila* subsp. *pattica* dhe *Iris variegata*. Edhe pse pa status ruajtje, llojet *Knautia macedonica*, *Linum tauricum* subsp. *albanicum* paraqesin shumë rëndësi për shkak të përhapjes së ngushtë që kanë në vendin tonë. Ato ndodhen vetëm në rrethin e Hasit. Në këtë territor të Shqipërisë ka shumë bimë mjekësore dhe aromatike ku më të përhapura si:



xhërrokulli vjeshtor (*Colchicum autumnale*), thundër mushka (*Tussilago farfara*), agulicja (*Primula veris*), luleshtrydhe (*Fragaria vesca*), rigoni (*Origanum vulgare*), rrush arushe (*Arctostaphylos uva-ursi*), trendafili i egër (*Rosa canina*), murrizi (*Crataegus monogyna*), molla e egër (*Malus sylvestris*), sanëza (*Gentiana lutea*), barpezmi mijëfletësh (*Achillea millefolium*) etj. Në ujërat sipërfaqësor të rrjetit hidrologjik të Hasit gjenden rreth 6 lloje peshqish të ujrave të ëmbla. Gjithashtu, në Has njihen 16 lloje amfibë dhe reptilë, 15 lloje shpendësh dhe rreth 30 lloje gjitarësh ku disa prej tyre janë gjitarë të mëdhenj si derri i egër, dhia e egër, ujku, ariu, dhelpra, macja e egër, lutra, etj.

### 1.3. Biodiversiteti i Kosovës

Kosova është një vend me sipërfaqe më të vogël se Shqipëria, por me biodiversitet gati po aq të pasur. Bazuar në studimet e deritanishme në Kosovë njihen rreth 1800 lloje bimësh enëzore, por mendohet që ky numër është më i madh dhe të arrij deri në rreth 2.500 lloje. Më të pasura floristikisht konsiderohen Bjeshkët e Nemuna dhe Malet e Sharri. Në këtë të fundit njihen gati 1.800 lloje nga të cilat 86 lloje janë shpallur ndërkombëtarisht të rëndësishme, 26 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe të Evropës dhe 32 lloje kanë status ruajtje sipas IUCN-së. Në zonën subalpine dhe alpine të Bjeshkëve të Nemuna njihen rreth 797 lloje të bimëve vaskulare (Millaku, F. 1999). Paraqesin vlera dhe interes të veçantë për larmin biologjike të Kosovës por edhe si një burim i të ardhurave ekonomike, rreth 70 lloje të bimëve mjekësore dhe aromatike.

Ekosistemet pyjore mbulojnë 42% e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës ose 464,800 ha. Nga kjo sipërfaqe rreth 278,880 ha janë toka pyjore në pronësi publike. Gati 90 % e pyjeve të Kosovës janë gjetherënëse dushku dhe ahu, kurse pyjet halor me pisha, bredh dhe hormoq përbejnë rreth 7 % të sipërfaqes pyjore.

Për sa i përket faunës, deri më tani njihen mbi 250 lloje vertebrorësh, rreth 200 lloje të fluturash, mbi 500 taksonë invertebrorë të makrozoobentosit të ujërave. Rezultatet e përfituara nga rezultatet e sudimeve tregojnë qartë se ky numër pritet të jetë shumë më i lartë. Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna janë zonat që konsiderohen më të pasura edhe për pasurinë faunistike të Kosovës.

#### 1.3.1. Biodiversiteti i Klinës

Klina karakterizohet nga larmi ekosistemesh. Sipërqje më të madhe zenë tokat bujqësore (12.734 ha) dhe pyjet (12.735 ha), pasuar nga livadhet (2.184 ha) dhe kullota (2.043 ha) (VSM, 2019). Rrjeti hidrologjik përfaqësohet nga Drini i Bardhë i cili është edhe më i madhi si dhe, Lumëbardhi i Pejës, Klina, Mirusha, Lumëbardhi i Deçanit dhe Lumi i Istogut.

Nga pasuria llojore floristike vlen të përmendet se në këtë territor të Kosovë gjejnë përdorim rreth 40 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike. Gjithashtu vlen të përmendet se në këtë territor të Kosovës gjenden një numër i konsiderueshëm bimësh endemike të Ballkanit si : boshtra evropiane (*Forsythia europaea*), bari i zgjebes (*Scabisa fumaroides*) moltkia Dorflerit (*Moltkia doerfler*), asteri Shqiptar (*Aster albanicus*), poligala e Dorflerit (*Polygala doerfleri*), gjineshtra e Hasertit (*Genista hassertiana*), halaçia e Sendtnerit (*Halascya sendtneri*), dioskorea e Ballkanit (*Dioscorea balcanica*), skutelaria lindore (*Scutellaria orientalis*), rrushqyqja e serpentine (*Sedum serpentina*), pendëkaposhi i Majorit (*Stipa mayeri*), veronica e Andrasovskit (*Veronica andrasovskyi*), *Malus florentina*, *Moltkia doerfleri*, et., (IPH 2012).

#### 1.4. Vlerat e biodiversitetit

Ekzistojnë shumë arsye për ruajtjen e biodiversitetit. Humbja e biodiversitetit, veçanërisht zhdukja e llojeve është shpesh e pakthyeshme, ndërkohë biodiversiteti është rezultat i qindra milion vjet evolucion dhe ai përbën një trashëgimi dhe pasuri e përbashkët, që ka vlera në shumë nivele:

1. Vlera e një trashëgimie të përbashkët: Biodiversiteti është një trashëgimi e ardhur nga historia e planetit tonë, nga evolucioni i botës së gjallë dhe shpesh nga ndërhyrjet e parardhësve tanë;
2. Vlera kulturore: Biodiversiteti është shpesh një komponent identifikues, simbolik ose edhe fetar, për grupe njerëzish apo shoqëri që kanë lidhje me të;
3. Vlera ekologjike: Biodiversiteti është themeli që mban ekosistemet dhe shërbimet që sigurojmë ne prej tyre si: pjelloria e tokës, pastrimi i ujit, ruajtja e ekuilibrit të gazeve atmosferike, rregullimi klimatik etj;
4. Vlera ekonomike: Biodiversiteti është burim pasurish. Ai i siguron njeriut ushqim, një pjesë të madhe të veshjes dhe shtrojeve të tij, shumë substanca farmaceutike dhe tërheqjen (atraksionin) në shumë zona turistike;
5. Vlera turistike: Biodiversiteti i pasur është një faktor i rëndësishëm për tërheqjen e interesit të turistëve dhe zhvillimin e industrisë së turizmit.
6. Vlera potenciale: Biodiversiteti paraqet një tërësi potencialesh të pa eksploruar, ose për shkak të mosnjohjes së tyre, ose për shkak se ato nuk i përgjigjen nevojave aktuale. Për ne na mbetet detyrë ta zbulojmë larminë e gjeneve dhe cilesitë e tyre.

Humbja e biodiversitetit është e dukshme, edhe kur pasojat e saj janë ende të papërcaktuara. Kjo humbje i detyrohet kryesisht veprimtarisë njerëzore të drejtpërdrejtë (humbja e habitateve natyrore, ndotja) dhe jo të drejtpërdrejtë (ndryshimet klimatike) ndaj është e domosdoshme të veprimit në çdo nivel.

Ruajtja e biodiversitetit dhe e ndërveprimeve midis llojeve dhe mjedisit të tyre është një mënyre e garantimit të së ardhmes evolutive të planetit dhe mbështetjes së aftësisë së tij për t'u përshtatur ndaj ndryshimit.



## REZULTATE TË PUNËTORISË

### 1.5. Vlerat e evidentuara të biodiversitetit të Hasit dhe Klinës

Popullësia lokale e zonave ndërkufitare e rrethit të Hasit dhe Klinës njih mirë burimet natyrore dhe marlin biologjike të territorit të tyre. Ky është një fakt që tregon se këta banorë historikisht kanë qënë dhe janë të lidhur ngushtë me shfrytëzimin e drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt të burimeve natyrore të zonës që përbëjnë vlera të mëdha për mbështetjen e jetës në këto troje shqiptare.

Gjatë diskutimeve në grup, në punëtorinë e organizuar në Has, për evidentimin e vlerave, kërcënimeve dhe masat e ruajtjes të biodiversitetit e kësaj zone ndërkufitare, për rrethin e Hasit u evidentuan disa burime natyrore që përbajnë vlera të rëndësishme për mbështetjen e jetës atje. Si ndër më kryesoret u përmendën:

1. Bimët mjekësorë: Kanë rëndësi të madhe në trajtimin me metoda popullore të sëmundjeve të ndryshme, por edhe për të ardhurat ekonomike që përfitohen nga mbledhja dhe shitja e tyre. Mali i Pashtrikut konsiderohen si më i pasuri me bimë mjekësore në të gjithë rrethin e Hasit. Bimët me përdorim më të madh dhe që mblidhen gjerësisht janë: sherebela, agulicja, molla e egër, vadhëza o se vodha, hithra, rigoni, sanza, trëndafil i egër, etj.
2. Pyjet, kullotat dhe tokat bujqësore. Pyjet e ahut, dushkut, pishës së bardhë etj., janë formacione të rëndësishme për mbrojtjen e tokës nga erozioni, sigurimiën e lëndës drunore, pastrimin e ajrit, strehimin e kafshëve të ndryshme, etj. Kullotat e Pashtrikut konsiderohen si më të mirat për nga përbërja floristike e tyre. Prania e shumë bimëve aromatike -mjekësore bënë që produktet e mishit dhe qumështit të bagëtive që kullojnë në këto zona të kenë cilësi të lartë. Tokat bujqësore janë të pakëta por ato paraqesin rëndësi të veçantë në prodhimin e disa produkteve bujqësore. Patatja e Hasit përbën një ushqim bazë të veçantë pasi mendohet të ketë edhe vlera kurative.
3. Dhia e Hasit është një rracë autoktone. Cilësia e produkteve të mishit dhe qumështit e saj janë shumë të larta dhe shumë të kërkuara edhe nga tregu ndërkombëtar. Ajo përbën edhe një pasuri të madhe dhe unike për të gjithë genofondin e Shqipërisë.
4. Bimët endemike janë pasuri unike e rrethit të Hasit. Përmendet Tulipani Shqiptarë, Tulipani i Kosovës, Epimedium, etj., si lloje që përveç se ngallin interes të botanistëve vendas dhe të huaj, janë dhe atraksion i madh për të afruar turistët natyrë-dashës.
5. Gjitarët e mëdhenj si ariu, ujku, dhia e egër, derri i egër, lepuri etj., konsiderohen gjithashtu një pasuri me vlera të mëdha ekologjike, ushqimore, turistike etj., për zonën e Hasit. Shpëndët grabitqarë si huta dhe shqiponja kanë rëndësi të madhe në pastrimin e territorit nga kafshët e ngordhura duke mos lejuar përhapjen e infeksioneve të ndryshme.

Për zonën e Klinës u evidentuan gjithashtu një larmi e madhe biologjike me shumë interes për banorët. Nga diskutimet për identifikimin e këtyre burimeve natyrore me vlera të drejtpërdrejta për banorët u përmendën si ndër më të rëndësishme:

- o Ekositemet lumore të rrjetit hidrologjik të pasur të Klinës. Lumenjt dhe përrenjt e këtij territori kanë rëndësi të madhe për sigurimin e ujit të pishëm dhe ujitje të tokave bujqësore; strehon disa lloje peshqish si trofta, dylberi, etj.; pastron mbetjet e ndryshme dhe ujërat e zeza të zonës, etj.
- o Bimët mjekësore dhe aromatike përbëjnë vlera të konsiderueshme edhe për Klinën. Ndryshe nga Hasi, në Klinë mblidhen dhe tregëtohen gjerësisht bimë mjekësore aromatike të kultivuara si kamomili, kalendula, mëllaga, menta, etj.

- o Gjitar të mëdhenj si derri i ëgër ka rëndësi të madhe. Ai është një atraksion për zhvillimin e sportit të gjuetisë në këtë zone por edhe burim ushqimi për banorët e zonave rurale dhe restorantent e zonës. Lopa e kuqe e Klinës konsiderohet gjithashtu një pasuri e veçantë për qumështin dhe mishin e saj cilësor.
- o Pasuritë minerale të kromit, hekurit dhe qymyrit të gurit përbëjnë burim natyrore të rëndësishme për Klinën. Shfrytëzimi i këtyre mineraleve krijon vende pune për një numër të madh banorësh duke siguruar të ardhura të drejtpërdrejta ekonomike.
- o Kanioni i Mirushës përbën një tërheqje të madhe turistike. Industria e turizimit në këtë zonë ka marrë zhvillim të madh falë këtij monumenti natyror që vizitohet çdo vit nga qindra-mijëra turist vendas dhe të huaj, duke siguruar të ardhura të konsiderueshme për zonën.

Disa prej vlerave natyrore të diskutuara teorikisht në punët e grupeve u evidentuan konkretisht përgjat rrugës dhe shtegut të ndjekur për në Malin e Pashtrikut. Në të dyja anët e rrugës që të shpie në fshtin Cahan, nëpër dushkajat e kësaj zone, u pa shumë e pranishme bima endemike e Ballkanit Forsythia europaea (boshtra). Me prani të madhe në këto substrate serpentinore është Centaurea kosaninii (kokoçel i Koshaninit), një bimë endemike e Shqipërisë. Në vëzhgimin e bërë në zonën e kullotave subalpine të Pashtrikut u vërejtën një sërë ekosistemesh të zonës si: pyjet e dushkut dhe ahut; kullotat alpine dhe subalpine me rëndësi të madhe për rritjen e bimëve të rralla dhe mjekësore; muret dhe shpatet shkëmbore shumë të veçanta të Pashtrikut që përbëjnë habitate ku jeton dhia e egër. Pejzazh shumë interes dhe i veçantë që u vërejt nga Mali i Pashtrikut është edhe zona karstike e Cahanit. Grobat karstike të kësaj zone kanë toka të pasura dhe shumë cilësore ku kultivohet patatja e Hasit.

## 1.6. Biodiversiteti dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm do të thotë përdorimi i burimeve biologjike apo natyrore për nevojat e sotme të njerëzimit, në përputhje me mbrojtjen e mjedisit, në mënyrë të tillë që të mos i hiqet e drejta brezave pasardhës për t'i shrytëzuar. Një mënyrë e tillë zhvillimi gërsheton kapacitetin mbajtës të një ekosistemi natyror me kërkesat dhe ambicjet e shoqërisë me të cilat përballet njeriu.

Pasuritë biologjike janë të ripërtëritshme dhe me përdorim të kujdesëm mund të shfrytëzohen nga njeriu pambarimisht. Për këtë nevojitet të hartohen politika të shfrytëzimit të tokës në përputhje me ruajtjen ose zgjerimin e larmisë biologjike, duke gërshetuar gjithmonë mundësitë dhe kërkesat ekologjike të çdo habitati me nevojat ekonomike, pra zbatimi i trekëndëshit të zhvillimit të qëndrueshëm.




Figura 2. Trekëndëshi i zhvillimit të qëndrueshëm

Zhvillimi qëndrueshëm kërkon ndërgjegjësim të gjithë shtresave shoqërore, shkallë të lartë përgatitjeje, njohjeje, vlerësim si dhe ligjshmëri të përshtatshme. Kjo përforcohet edhe nga sigurimi i një informacioni të besueshëm mbi biodiversitetin dhe mbi parametra të tjerë që ndihmojnë në parashikime të mundshme. Në këtë pikëpamje merr rëndësi edhe ecuria e zhvillimit duke ndjekur një plan menaxhues të mbështetur në kritere sa më të drejta dhe sa më të drejta dhe sa më shkencore.

## 2. KËRCËNIMET E BIODIVERSITETIT

### 2.1 Kërcënimet e biodiversitetit të trojeve shqiptare

Kërkesat për zhvillimi infrastrukturor, industrial, bujqësor, turistik, energjistik, etj., shoqeruar nga mosrespektimi i kapaciteteve të burimeve natyrore dhe të mos kuptuarit e rëndësisë që ka larmia biologjike, ka çuar në një zhvillim jo të qendrueshëm i cili shpesh po përballlet me kriza të mëdha. Praktikrat e aplikuara në bujqësi, industri, pylltari, peshkim, urbanizim etj., kanë dhënë ndikim të madh negativë në larminë llojore dhe ekosistemeve të vendit.

Tharja e kënetave, bonifikimi, shpyllëzimet për hapjen e tokave të reja, tarracimi i kodrave dhe maleve, ndërhyrjet në kullotat malore për të hapur toka të reja bujqësore ose përmirësismin e tyre, kanë rezultuar negative për mjedisin dhe biodiversitetin. Këto ndërhyrje kanë shkaktuar erozion të lartë, përmbytje në zonat bregdetare, shtimi i zonave jo produktive (të braktisura ose të shkatërruara), degradim të peizashve natyrore, etj. Plehrat kimike dhe pesticidet e përdorura pa kriter kanë ndikuar drejtpërdrejt në dëmtimin e florës dhe faunës së egër duke e helmuar atë dhe në ndotjen e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.

Shfrytëzimi pa kriter i ujërave të brendshme sipërfaqësor për ujitje ose prodhim energjie ka çuar në stres dhe në kriza për këto ekosisteme, veçanërisht liqenet e vegjël si i Prespës së vogël, liqenet e Dumresë dhe liqënët akullnajore të Lurës. Shfrytëzimi ose devijimi i rrjeteve lumore për hapjen e tokave bujqësore ose prodhim energjie nga hidrocentralet ka çuar në humbje të ekosistemeve lumore së bashku me florën dhe faunën e tyre dhe përmbytje të habitateve tokësore përreth tyre. Basenet ujore të këtyre hidrocentraleve dhe autostradat rrugore janë edhe elementet kryesore që bëjnë fragmentimin e habitateve duke kërcënuar llojet që jetojnë në to. Hivillimi qëndrueshëm kërkon ndërgegjesim të gjithë shtresave shoqërore, shkallë të lartë përgatitjeje, njohjeje, vlerësimi si dhe ligjshmëri të përshtatshme. Kjo përforcohet edhe nga sigurimi i një informacioni të besueshëm mbi biodiversitetin dhe mbi parametra të tjerë që ndihmojnë në parashikime të mundshme. Në këtë pikëpamje merr rëndësi edhe ecuria e zhvillimit duke ndjekur një plan menaxhues të mbështetur në kritere sa më të drejta dhe sa më shkencore.

Faktorë negativ që rrezikojnë seriozisht në shkallë masive biodiversitetin e vendit janë edhe shkarkimet e mbetjeve industriale dhe urbane të pa përpunura. Shqetësuese janë shkarkimet e mbetjeve të metalurgjikut të Elbasanit në lumin e Shkumbinit dhe shkarkimet e mbetjeve të naftës nga fusha e Patos-Marinzës në lumin e Gjanicë, etj. Shumë shqetësuese, me ndikim të madh në biodiversitet por edhe në shëndetin e banorëve janë dhe shkarkimet e gazrave të KEK në Fushë Kosovë.

Shpyllëzimet masive e të pakontrolluara që janë bërë në Shqipëri kanë qënë gjithashtu një faktor i madh kërcënues të biodiversitetit. Që nga viti 1953, sipërfaqja e zonave pyjore është ulur me rreth 300.000 ha, sipërfaqe kjo që përbën 22% të sipërfaqes pyjore të mëparshme ose 30% e pyjeve ekzistuese.

Si të gjitha vendet edhe biodiversiteti i trojeve Shqiptare nuk mund t'i shpëtoj kërcënimit nga ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale. Katastrofat mjedisore janë gjithmonë e më të shpeshta duke kërcënuar seriozisht biodiversitetin. Mjafton të kujtojmë që kemi gjithmonë e më shumë përmbytje apo rreshqitje masive të tokës nga shirat intensive që bjenë në një periudhe shumë të shkurtër, për të kuptuar se si jeta në tokë po kërcënohet nga ndryshimi i këtyre faktorve natyrore.

## REZULTATE TË PUNËTORISË

### 2.1.1. Faktorët që kërcënojnë biodiversitetin e Hasit dhe Klinës

Biodiversiteti i zonës së Hasit dhe Klinës ashtu si në gjitha trojet Shqiptare dhe më gjerë, gjendet nën presionin e disa faktorëve kërcënues. Gjatë punës në grupe të përbërë nga banorë të këtyre zonave u identifikuan disa faktor kërcënues të biodiversitetit të tyre. Faktorët kryesor kërcënues për biodiversitetin e rrethit të Hasit janë:

1. Prerjet e pa kontrollura të pyjeve. Nga këto prerje janë shpyllëzuar sipërfaqe të mëdha pyjore duke çuar në humbje ekosistemi, dëmtim të pejzazhit natyror, humbje të habitateve natyrore të florës dhe faunës dhe erozion të shpateve malore.
2. Zjarret të cilën djegin pyje e kullota duke zhdukur llojet bimore dhe shtazore, habitatet e tyre dhe zhvesh sipërfaqe të tëra toke duke i ekspozuar ndaj erozionit.
3. Ndotja nga mbetjet urbane përbën kërcënim edhe në rrethin e Hasit. Mungesa e ndërgjegjësimit të popullsisë dhe e koshave nëpër zonat rurale të Hasit ka bërë që këto mbetje të hidhen në natyrë duke ndotur ekosistemin. Shqetësim paraqet edhe përdorimi i pesticideve të ndryshme pa kriter.
4. Gjutia e paligjshme: Gjitarët e mëdhenj si lepuri dhe dhia e egër janë objekt i gjetisë së paligjshme që ashtu si në mbarë vendin ka ulur shumë popullatën e këtyre llojeve. Objekt i gjetisë janë edhe lloje të tjera që gjuhen pa kriter dhe jashtë sezonit të lejuar.
5. Ndërtimet në tokat bujqësore: Hasi është një rreth malor ku tokat e punueshme dhe produktive janë të kufizuara. Në 30 vitet e fundit edhe në këtë rreth është duke u ndërtuar pa kriter duke zënë tokat bujqësore që paraqesin një ekosistem të rëndësishëm me vlera dhe përfitime të drejtpërdrejta për popullatën.

Biodiversiteti i Klinës gjendet gjithashtu nën presionin e faktorit antropogjen që është më i lartë pasi edhe pupullsia e saj është më shumë se dy herë e madhe se e Hasit. Për këtë zonë u identifikuan këta faktorë kërcënues të biodiversitetit:

1. Shkarkimet industriale: Zhvillimi industrive të vogla pa kriter dhe pa një plan të mirëfilltë studimi të ndikimit në mjedis ka bërë që në zona të ndryshme të ngihen punishte të shumta që shkarkojnë mbetjet e tyre në mjedis pa asnjë lloj përpunimi për të ulur ndotjen.
2. Humbja dhe fragmentimi i habitateve: Infrastruktura rrugore është faktor kryesor për fragmentimin e ekosistemeve pyjore por edhe atyre bujqësore. Trafiku rrugor është kërcënim edhe për faunën. Amfibë, reptilë por edhe gjitarë të ndryshëm shpesh vriten nga automjetet gjatë përpjekjes për të kaluar rrugën.
3. Guroret : Hapja e guroreve të reja dhe zgjerimi pa kriter i atyre ekzistuese ka bërë që shumë ekosisteme së bashku me habitatet dhe jetën e egër (florë dhe faun) të zhduken. Këto gurore janë edhe ndër faktorët kryesorë të dëmtimit të pejzazhit të zonës.
4. Ndërtimet pa kriter: Zënia e tokës bujqësore nga ndërtimet është një faktor kërcënues që dëmton ekosistemet bujqësore. Lagjet e reja të banimit bëjnë edhe fragmentimin e këtyre ekosistemeve. Ky faktor kërcënues vlerësohet si më seriozi në rrethin e Klinës.
5. Prerjet dhe djegia e pyjeve: Prerjet pa kriter dhe zjarret kanë bërë që sipërfaqe të mëdha pyjore të zhvishen nga pyjet duke dëmtuar llojet bimore dhe shtazore, humbje të habitateve dhe erozion të shpateve kodrinore e malore.

Gjatë ekspeditës të zhvilluar në Malin e Pashtrikut me pjesëmarrësit e punëtorisë të zhvilluar në tetor 2021, u vërejtën disa faktor kërcënues për biodiversitetin e zonës. Disa nga këta faktorë kërcënues si prerja e drurëve apo shpyllëzimt masive u vlerësuan si faktor që kanë qënë shumë shqetësuese në të kaluarën por tashmë jo.



Rezultat i këtyre prerjeve janë gati të gjithë pyjet e përzjera të dushkut në të dyja anët e rrugës nga Hasi në Cahan. Drurët e këtyre pyjeve kanë thujse të njëjtën moshë, jo më të vjetër se 20-25 vite. Ky është një tregues se në këtë periudhë këta pyje janë prerë masivisht dhe sot janë duke u rigjeneruar

Faktor kërcënues aktual dhe shumë shqetësues për biodiversitetin u vlerësua një gurore masive rreth 2 km para se të shkosh në fshatin Cahan e cila ka shatërruar florën dhe faunën e asaj zone së bashku me habitatet e tyre duke dëmtuar edhe peizazhin përreth. Kullotja herët në pranverë, sapo shkrin bora, u vlerësua gjithashtu si faktor kërcënues që po dëmton seriozisht kullotat e Pashtrikut. Kjo praktik e gabuar (e ngjashme me gjuetinë jashtë sezonit) po dëmton llojet barishtore pasi nuk i lihet kohë që të marin veten nga dimri dhe të lulëzojnë e fritifikojnë.

### **3. MBI RUAJTJEN DHE MENAXHIMIN E BIODIVERSITETIT**

#### **3.1. Biologjia e Ruajtjes si përgjigje e zgjuar për ruajtjen e biodiversitetit!**

Biologjia e Ruajtjes është një përgjigje aktuale ndaj valës së ndryshimeve globale mjedisore të cilat kërcënojnë me zhdukje një pjesë të konsiderueshme të larmisë biologjike botërore. Biologët e ruajtjes kanë si detyrë kryesore sigurimin e mjeteve intelektuale dhe teknologjike që do të paraprijnë, parandalojnë, minimizojnë dhe riparojnë dëmtimin e natyrës.

Biologjia e Ruajtjes ndryshon shumë nga shkencat e tjera biologjike. Ajo është zakonisht një disiplinë e krizave dhe shpesh duhet të veprojë për rpara se të njihen gjithë faktet apo shkaqet. Biologjia e Ruajtjes është shumë disiplinore në strukturë. Pjesa më e madhe e ideve, teknikave dhe metodave vijnë nga një spektër i gjerë fushash të biologjisë si: ekologjia, biogeografia, sistemetika, gjenetika, evolucioni, epidemiologjia, pylltaria, peshkimi, biologjia e jetës së egër, agronomia dhe shkencat veterinarë. Gjithashtu përfshin edhe disiplina të shkencave shoqërore si ekonomia dhe politika e burimeve, etnobiologjia dhe etika mjedisore.

#### **3.2. Menaxhimi mjedisor si përgjigje për ruajtjen e biodiversitetit**

Menaxhimi i mjedisit nuk është menaxhim klasik si i çdo aktiviteti apo biznesi, por është një menaxhim i ndërveprimit të aktiviteteve dhe sjelljeve moderne të njërëzimit me mjedisin ku jeton. Tri çështjet kryesore që ndikojnë te menaxherët e mjedisit janë: politikat menaxhuese, programet ose projektet e zhvillimit dhe burimet e të ardhurave. Filozofia kryesore e menaxhimit të mjedisit është koncepti i aftësisë mbajtëse që i referohet numrit maksimal të organizmave që një burim i veçantë natyrorë mund të mbështesë. Konceptit të aftësisë mbajtëse të mjedisit po i mëshohet gjithmonë e më shumë pasi është kuptuar se e gjithë kjo punë nuk bëhet vetëm për hirë të mjedisit, por për vetë njerëzimin dhe të brezave pasardhës.

Menaxhimi mjedisor përfshin të gjithë përbërësit e mjedisit, të gjallë (biotik), jo të gjallë (abiotik) dhe marrëdhëniet midis tyre, përfshirë edhe njeriun me mjedisin e tij shoqëror, kulturor ekonomik, etj. Në shkallë globale, menaxhimi mjedisor në bazë të parimeve të qëndrueshmërisë përfshin menaxhimin e deteve, oqeanëve, sistemet e ujërave të ëmbla, tokës dhe atmosferës. Ashtu si të gjitha fushat e efektshme të menaxhimit edhe ai mjedisor ka standarde që zbatohen për të reduktuar ndikimet negative në mjedis. Më i përdorur është standardi ISO 14001.

Menaxhimi i jetës së egër si pjesë e menaxhimit mjedisor, është kombinim i shkencës dhe artit. Menaxhimi i jetës së egër ka të bëjë kryesisht me aplikimin e biologjisë së ruajtjes dhe sidomos ekologjisë. Menaxherët e saj përdorin të dhënat shkencore për marrëdhëniet në lidhje me popullatat dhe habitatet. Ata gjithashtu kërkojnë manuale dhe aftësi komunikuese që arrihen përmes përvojës. Ata përdorin gjykimin dhe bëjnë kompromise sidomos kur vendimet duhet të bazohen në informacion të kufizuar.

Planet e Menaxhimit mjedisor përfaqësojnë kërkesat mjedisore, të cilat vihen në dukje nga një proces i gjerë dhe i thellë i njohjes së gjendjes mjedisore, i mbështetur gjithashtu edhe në vlerësimin real të kostove për zgjidhjen e tyre, të burimeve të mundshme financiare, burimeve njerëzore dhe të përgjegjësive ekzistuese për zbatimin e tij. Hartimi i një plani nuk duhet konceptuar si dokument përfundimtar i bërë një herë e përgjithmonë, por si proces i vazhdueshëm që kërkon të rishihet dhe përshtatet në përputhje me gjithë zhvillimet e mundshme në rajonin përkatës.

### **3.2.1. Parimet themelore për planifikimin dhe hartimin e një plani ruajtje dhe menaxhimi të biodiversitetit!**

Mbrojtja e biodiversitetit dhe arritja i zhvillimit të qëndrueshëm kërkon ndërgjegjësim të të gjithë shtresave shoqërore, shkallë të lartë përgatitjeje, njohje, vlerësim si dhe ligjshmëri të përshtatshme që përforcohet edhe nga sigurimi i një informacioni të besueshëm mbi biodiversitetin. Në këtë kë ndvështrim vihet në dukje rëndësia e një plani menaxhues i mbështetur në kritere sa më të drejta dhe sa më shkencore. Por, çfarë duhet të përmbajë një plan ruajtje dhe menaxhimi i larmisë biologjike?

Plani i menaxhimi i larmisë biologjike duhet të përmbajë:

1. Gjendjen (Statusin) aktuale të biodiversitetit ku paraqiten arsyet që shpjegojnë këtë gjendje dhe deri në ç'skallë njihen faktorët kufizues.
2. Faktorët që shkaktojnë humbje apo përkeqësim të biodiversitetit. Bëhet një paraqitje e shkurtër e faktorëve kërcënues të shkuar dhe të sotëm.
3. Masat ruajtëse të deritanishme. Paraqiten shk urtimisht në se ka pasur masa mbrojtëse deri tani dhe çfarë po bëhet për momentin për ruajtjen e llojit/habitatit.
4. Paraqiten objektivat e planit të menaxhimit që vihen për ruajtjen, përmirësimin apo rritjen e popullatës së llojit ose zgjerimin e përhapjes gjeografike të llojit apo habitatit.
5. Veprimet , aksionet dhe masat e propozuara si dhe agjencia drejtuese ose përgjegjëse. Paraqiten aksionet ose veprimet që do të ndërmerren për arritjen e objektivave; ç'është duke u bërë, çfarë mund apo duhet shtuar etj. Aspektet vepruese kanë të bëjnë me: politikat dhe legjislacionin e vendit; ruajtjen dhe menaxhimin e zonës ; mbrojtja dhe menaxhimi i llojit/habitatit; këshillimi; kërkim i mëtejshëm shkencor dhe monitorimi; komunikimi dhe publikimi.

Objektivat janë përbërësit më të rëndësishëm të ç do plani ruajtje dhe menaxhimi sepse në varësi të tyre përcaktohen rezultatet e tij. Nga strategjitë më të suksesshme për hartimin e objektivave është metoda SMART, përgjithësisht e aplikuar në fushën e biznesit, por me disa modifikime mund të aplikohet edhe për hartimin e objektivave të planeve të menaxhimit për jetën e egër:

**S**= për të arritur rezultate të kënaqëshme, objektivat duhen të jenë SPECIFIKE.

**M**= për të arritur rezultate të kënaqëshme, objektivat duhen të jenë të MATSHME.

**A**= për të arritur rezultate të kënaqëshme, objektivat duhen të jenë të ARRITSHME.

**R**= për të arritur rezultate të kënaqëshme, objektivat duhen të jenë të REALISTE dhe të jenë në përputhje me strategjitë, politikat dhe detyrimet ligjore që rregullojnë organ izimin e planeve të menaxhimit.

**T**= objektivat duhen të na japin rezultate në një KOHË jo të largët, megjithatë duhet të pranojmë se në planet e menaxhimit të natyrës, koha e përfitimit të rezultateve nuk është fikse, por e rëndësishme është marrja e statusit që ne kërkojmë dhe më pas mbajtjen e këtij statusi.

Objektivat e një plani menaxhimi janë më shumë shpresë-dhënëse në se zona ku synohet të ruhet jeta e egër është ose ka gjasa të pë rfishihet në programe të medha si Ramsar, si



UNESCO, Natura 2000 etj. Në këto raste zona të tilla marin statusin e 'zonave të favorizuara për ruajtjen e jetës së egër' (FCS). Parimet e përgjithshme të një plani menaxhimi duhet të jenë gjithëpërfshirëse . Përveç karakteristikave planifikuese e menaxhuese të mbrojtjes së natyrës, planet duhet të marrin në konsideratë interesat e palëve të interesuara, aspektet kulturore (historike, arkeologjike, fetare dhe interesat shpirtërore), menaxhimin e vizitorëve, turizmit dhe aspektet sociale e ekonomike.

Parimi parandalues është i rëndësishëm në kontekstin e ruajtjes për planifikimin e menaxhimit dhe duhet të udhëheqë procesin e planifikimit. Planifikuesit duhet të njohin nevojën për të ndërthurur zonën (site) e planifikuar për ruajtjen e jetës së egër me plane më të gjera sektoriale apo të shfrytëzimit të kësaj zone.

Qasja e planifikimit duhet të jetë sa më pak e komplikuar (sa më thjeshtë aq më mirë). Planet e menaxhimit duhet të kuptohen lehtësisht nga të gjithë grupet e interesit dhe gjuha e përdorur duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë. Planet duhet të kenë një përmbledhje të shkruar qartë dhe shtimi i hartave/skicimet ndihmojnë për të shpjeguar çështjet e trajtuara. Individët e përfshirë në menaxhimin, kur është e mundur, duhet të përfshihen në procesin e planifikimit.

Planifikimi i menaxhimit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe ciklik, përsëritës dhe zhvillimor ku monitorimi duhet të njihet si pjesë përbërëse dhe thelbësore e çdo procesi të planifikimit dhe është praktikë e mirë regjistrimi i të gjitha veprimeve e ndërmarra në përputhje me një plan.

Të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në një tipar që menaxhohet duhet të identifikohen dhe të përfshihen në procesin e planifikimit. Këto ndikime mund të jenë të momentit, të kenë ekzistuar në të kaluarën ose mund të ekzistojnë në të ardhmen. Faktorët mund të jenë me origjinë natyrore ose të krijuar nga veprimtaria njerëzore, mund të jenë të brendshme (pjesë e zonës ose burimit natyror që synohet të menaxhohet) ose të jashtëm. Planet e menaxhimit dhe veprimet duhet të përthithin praktikën më të mira aktuale dhe të jenë të hapur për ide të reja dhe inovative.

### **3.3. Kush duhet ta ruaj biodiversitetin?**

Menaxherët e ruajtjes, sa është e mundur, duhet të njohin nevojën për të adoptuar një qasje e cila merr parasysh interesat e të gjitha palëve të interesuara dhe nxit përfshirjen e tyre në të gjitha aspektet e planifikimit të menaxhimit dhe në menaxhim. Një nga çështjet kyçe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve të sukseshme është vlerësimi i përbashkët i atyre çështjeve që mund të diskutohen për t'u ndryshuar.

Mbështetja dhe bashkpunimi për procesin e planifikimit është thelbësor. Një plan ruajtje menaxhimi është një investim me kosto e që kërkon kohë, mund dhe energji ndaj në përgjithësisht merren seriozisht por një nga pikat e dobëta që mund ta bëjnë atë jo të sukseshëm është pikërisht mospërfshirja e të gjitha grupeve të interesit, sidomos e popullësisë vëndase.

### **3.4. Legjislacioni dhe institucionet përgjegjëse për ruajtjen e mjedisit dhe biodiversiteti në Shqipëri**

Ligji bazë në fushën e mjedisit ka ekzistuar që në vitin 1967, por zhvillimi i një sistemi ligjor të kohës për mbrojtjen e mjedisit bazuar në parimet demokratike filloi në vitin 1991. Në këtë periudhë Shqipëria filloi të marrë pjesë në organizatat dhe konventa ndërkombëtare mjedisore, duke u përpjekur të përmbush detyrat e saj ligjore.

Në Republikën e Shqipërisë biodiversiteti është i ruajtur me ligj, konkretisht ligji Nr.9587, datë 20.7.2006 'Për Mbrojtjen e Biodiversitetit', i përditësuar për herë të fundit në vitin 2020. Qëllimi i hatimit të një ligji të posaçëm është: Të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit; të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik; Të sigurojë ngritjen e rrejtës për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër në territorin e Republikës së Shqipërisë; Të përcaktojë masa për të mbajtur ose rivendosur në një status të favorshëm ruajtjeje habitatet natyrore dhe llojet e faunës së egër të Shqipërisë dhe me interes për Komunitetin Europian; Të sigurojë që masat e ndërmarra, në zbatim të këtij ligji, të marrin në konsideratë kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe karakteristikat rajonale.

Sipas këtij ligji Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) është institucioni qendror përgjegjës për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të tij. Për të siguruar ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të racave dhe të varieteteve autoktone të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, është përgjegjëse Ministria e Bujqësinë.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore - Drejtoria e Politikave dhe Strategjive Mjedisore pranë MTM është drejtoria kryesore e ruajtjes së Biodiversitetit. Të tjera institucione të MTM-së që kanë për detyrë ruajtjen e biodiversitetit të Shqipërisë në përputhshmëri me ligjet kombëtare dhe konventave ndërkombëtare janë:

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) e cila ka përgjegjësinë e menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM ka 12 deget e saj në çdo prefekturë të Shqipërisë dhe menaxhon rreth 18% të territorit Shqiptar si zona të mbrojtura;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit që është institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin e biodiversitetit dhe vlerësimin apo licensimin e aktiviteteve që ndodhin në zona natyrore dhe ndikojnë në vlerat e biodiversitetit;
- Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Territorit që është përgjegjës për mbikëqyrjen, inspektimin dhe zbatimin në përgjithësi të ligjit për çështje që lidhen me ruajtjen e natyrës.

Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës (QKFF) është një nga institucionet më të rëndësishme për studimin dhe ruajtjen e biodiversitetit, unikal në llojin e tij saj në Shqipëri. Ky departament kërkimore-mësimor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT, ka si qëllim kryesor studimin e florës dhe faunës të Shqipërisë duke kontribuar drejtpërdrejt në ruajtjen e biodiversitetit të Shqipërisë. Dy njësitë përbërëse të QKFF-së janë:

1. Kopështi Botanik: është një institucion shkencor-mësimor-çlodhës, ku studjuesit e florës dhe të apasionuarit pas bimëve e natyrës në përgjithësi, mund të shohin e të njohin mjaft bimë të Florës Shqiptare e jo vetëm. Ai është themeluar në vitin 1971 dhe ka një sipërfaqe prej rreth 13.5 ha ku strehohen rreth 800 taksonë lloje dhe nënlloje bimore, kryesisht të florës shqiptare. Tematika shkencore e Kopshtit Botanik është e karakterit ruajtës së florës Florës Shqiptare. Kjo bëhet nëpërmjet grumbullimit të materjalit bimor të gjallë ose farave të tyre, mbjelljes, shumimit, dhe katalogimin e taksonëve të florës spontane, përfshi këtu edhe atë të bimëve të rralla e të rrezikuara, endemike, si dhe të bimëve me vlera përdorimi.
2. Muzeu i Shkencave të Natyrës, i themeluar në 1948, përfaqëson një pasuri të rrallë kombëtare dhe me vlera shkencore dhe kulturore. Në të gjenden shtatë pavijone ku janë ekspozuar mbi 3000 eksponentë vendas dhe të huaj, dhe mijëra përfaqësues në fondin shkencor të larmishëm nga fauna tokësore, detare, e lumenjve, ujërave të mjelmëta, kafshë që nga koralet mahnitës shumë ngjyrësh të ngulur e të palëvizshme,

molusk të llojeve të ndryshme deri guaskat e Oqeanit Indian; insekte me pamje dhe ngjyra mahnitëse, peshqi të llojeve të ndryshme; amfibë dhe reptilë mbresëlënës që nga gjarpërinjtë e deri tek breshkat e mëdha detare; shpendë të mrekullueshëm, ku padyshim pelikani kaçurrel mbetet unik; gjitarë me pamje madhështore që nga majmunët e Afrikës e deri tek ariu i pyjeve dhe balena e deteve.

Në ambientet e muzeut gjendet edhe Herbari Kombëtar i cili përfaqëson koleksion bimësh të vendit, të thara e të sistemuara sipas kritereve të caktuara, që përdoret për qëllime studimi, konsultimi, dokumentimi dhe krahasimi. Ai shërben si fond bazë për kryerjen e studimit mbi florën e Republikës së Shqipërisë, mbi florat krahinore si dhe për studime të tjera me karakter teorik, praktik dhe didaktik në fushën e botanikës. Ky fond është rezultat i një pune gati 70 vjeçare i botanistëve shqiptarë, ku nuk ka munguar dhe kontributi i botanistëve të huaj, sidomos lidhur me përcaktimin e specieve të ndryshme bimore. Si i tillë ai përbën një pasuri kombëtare me vlera të mëdha shkencore, didaktike dhe praktike.

### **3.5. Mbi ruajtjen e biodiversitetit të Shqipërisë**

Për të ruajtur biodiversitetin së bashku me vlerat që mbart nga një sërë kërcënimësh të trajtuara më sipër, në Shqipëri është krijuar Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura. Së bashku me monumentet e natyrës janë 800 zonash të tilla që përfshihen në këtë rrjet të cilat zënë rreth 16% të sipërfaqes së territorit të vendit.

Disa nga zona të Rrjetit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura por edhe zona të tjera me vlera për biodiversitetin jashtë këtij rrjeti janë pjesë e rrjeteve të ndryshme ekologjike ndërkombëtare si: 4 zona ligatinore RAMSAR të ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1996; 2 zona të mbrojtura nga UNESCO; zonat ndërkufitare (ish klonet kufitare) janë të përfshira në Rrjetin e Brezit të Gjellbër të Evropës; 16 zona të rëndësishme për shpendët në nivel global janë të njohura nga Organizata Ndërkombëtare për Ruajtjen e Shpendëve (Bird Life International); 29 Zonash Kyç për Biodiversitetin (ZKB) në nivel global; 25 zona Emerald të propozuara nga Shqipëria në kuadër të detyrimeve që burojnë nga ratifikimi Konvetës së Bernës. Në hartën e figurë3 shikohet së më shumë se ngjysma e territorit të Shqipërisë ka një status ruajtje apo menaxhimi. Rreth 53.4% e territorit (15342 km<sup>2</sup>) ka statusin e Zonës Kyç për Biodiversitetin (ZKB) dhe së bashku me pjesën tjetër të territorit që nuk e ka këtë status por që përfshihen në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura dhe rrjete e tjera ekologjike, kjo sipërfaqe shkon në rreth 60% të territorit.

Si shtet që synon pjesë të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, Shqipëria ka si detyrë të njësoj legjislacionin kombëtar për ruajtjen e natyrës me atë të BE-së nëpërmjet transpozimit të Direktivave Evropiane të Shpendëve dhe Habitaveve. Në kuadër të transpozimit të këtyre ligjeve në 2017 u miratimi i ligji nr. 81/2017 për Zonave të Mbrojtura, i cili përfaqëson njehsimin në masë të të gjerë legjislacionin kombëtar për ruajtjen e biodiversitetit me atë të BE-së (EU Policy Hub, 2017).




Figura 3. Zonat e rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit (EU Policy Hub, 2017).

### 3.6. Ruajtja e mjedisit dhe biodiversitetit në Kosovë

Në Kosovë iniciativat e para për ruatjen ligjore të natyrës kanë filluar para viteve 60të, por u konkretizuan vetëm në fund të kësaj dekade. Konkretisht, në vitin 1968 u formua njësi për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës. Kuvendi i Kosovës në vitin 1988 miratoj ligjin për 'Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut'. Në nënin 78 paragrafi 2 të këtij Ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit. Duke u bazuar në këtë ligj, një vit më vonë Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit. Pas luftës, në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emrin "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës" me seli në Prishtinë. Në maj të këtij viti u themelua Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit nga i cili vareshin edhe institucionet ekzistuese si: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës (IKMN), Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Malet e Sharrit". Një vit më vonë (2001) formohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit e cila ndër të tjera është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe ligjeve për mbrojtjen e mjedisit me të gjithë elementët e tij përfshir biodiversitetin, si edhe të mbikqyrë zbatimin e tyre (Sherifi et al., 2005).



**Figura 4.** Harta e zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës së Kosovës (Sherifi et al., 2005).

Aktualisht IKMN është pjesë e Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe që nga themelimi i tij si institucion qendror për mbrojtjen e natyrës, ka marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera të tjera natyrore. Deri me sot Kosova ka në mbrojtje ligjore një sipërfaqja prej 46.247.3 ha ose 4.27 % e territorit të vendit. Në këto sipërfaqe të mbrojtura përfshihen: Parku Kombëtar Malet e Sharrit, 11 rezervate të natyrore, 37 monumente natyre dhe 2 peizazhe të mbrojtura (Fig. 4).



### 3.7. Masa dhe veprimtari të sugjeruara për ruajtjen e biodiversitetit të Hasit dhe Klinës

Pas evidentimit të vlerave të biodiversitetit të Hasit dhe Klinës dhe faktorëve kërcënues të këtyre vlerave, nga puna në grupe e pjesmarrësve në punëtori u nxorrën edhe disa përfundime mbi masat dhe veprimtaritë që duhen të ndërmerren për ruajtjen e biodiversitetit të këtyre zonave ndërkufitare. Nga të dyja palët e pranishmeve që përfaqësonin grupe të ndryshme interesi, në lidhje me masat ruajtëse të biodiversitetit theksi vendos në:

1. Edukimi dhe ndërgjegjësimi të popullatës: Për këtë u sugjerua që aktivitete dhe veprimtari të ndryshme edukuese-ndërgjegjësuere për vlerat që mbart biodiversiteti dhe kërcenimet që i kanosen atij duhet të jenë të shumta. Trajtimi i temave të tilla shikohet me shumë interes edhe për tu bërë pjesë e teksteve mësimore që në fazat e hershme të arsimimit të fëmijëve.
2. Forcimi i zbatimit të ligjeve: Ligjet për ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit në veçanti konsiderohen të mirë por zbatueshmëria e tyre lë për të dëshiruar. Më shumë penalitete duhet të vendosen për të gjithë ata që veprojnë kundër këtyre ligjeve.
3. Mbështetje me staf dhe burime financiare e institucioneve që mbrojnë mjedisin. Kapacitetet aktuale të këtyre institucioneve vlerësohen si të pa mjaftueshme dhe me numër të vogël stafi për të monitoruar dhe menaxhuar problematikat e shumta mjedisore në të gjithë teritorin. Shpesh zyrat lokale për sektorë të ndryshëm të mjedisit përballen edhe me mungesa financiare.



## BIBLIOGRAFIA

EU Policy Hub (2017): Ruajtja e natyrës dhe rëndësia e saj në procesin e integritimit.

Hajdari A., Zeqiri E. (2021 - 2025): Shërbimet e Ekosistemit dhe Investimet Publike Inteligjente në Komunën e Klinës. Plan Veprimi.

Kabo M. (1990-1991): Gjeografia Fizike e Shqipërisë. Tirana: Vol. 1 -2

Meço M., Mullaj A. (2015): Phenological Aspects of Albanian Flora. Proceeding International Conference On Soil. 04 – 06 May 2015, Agricultural University of Tirana, Tirana, Albania. Proceedings: ISBN: 978-9928-110-58-9: 164

MILLAKU F.(1999): Flora Subalpike dhe Alpike e Alpeve Shqiptare (Kosovë) mscr. Teza e Doktoratës. Prishtinë.

Qendra EDEN (2021 - 2025): Shërbimet e Ekosistemit dhe Investimet Publike Inteligjente në Bashkin Has. Plan Veprimi.

Sherifi Y., Berisha A., Krasniqi E., Shkodra N., Maxhuni Q., Dabinovci V., Elshani A., Veselaj T., Hajdari R., Hoti H., Bajraktari F., Hajra H., Behrami S. (2005): Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës. Instituti i Kosovës Për Mbrojtjen e Natyrës, Kosovë.

